

**MANUAL PËRDORIMI PËR BKT SMART
iOS**

PËRMBAJTJA

KUSHTET E DOMOSDOSHME PËR PËRDORIMIN E BKT SMART	4
1. INSTALIMI I BKT SMART	4
2. INFORMACION PA HYRË NË BKT SMART	5
3. REGJISTRIMI NË BKT SMART	8
4. HYRJA NË BKT SMART	9
4.1 HYRJA ME NUMËR KLIENTË OSE NUMËR PERSONAL.....	9
4.2 HYRJA ME TË DHËNAT E KARTËS SË DEBITËT OSE KREDITËT.....	9
4.3 HYRJA ME TË DHËNAT BIOMETRIKE	10
5. MENU	12
6. LLOGARITË	12
6.1 LLOGARITË RRJEDHËSE	13
6.1.1 Hapje Llogarie	13
6.2 KURSIME.....	14
6.2.1 Hap Llogari Kursimi	15
7. DEPOZITAT	15
7.1 DEPOZITAT E MIA	15
7.2 HAP DEPOZITË	16
7.3 MBYLL DEPOZITË	16
8. KARTA E DEBITIT	17
8.1 LIDH LLOGARI	17
8.2 NDAJ LLOGARI	17
9. KARTAT E KREDITIT	17
9.1 INFO E KARTËS	18
9.2 PASQYRAT	18
9.3 TRANSAKSIONET E FUNDËT	18
9.4 PAGESË KARTE.....	18
9.4.1. Paguaj kartën time.....	18
9.4.2. Pagesë e një karte tjetër.....	19
9.5 TËRHEQJE.....	19
9.6 LIMITI NË INTERNET.....	19
9.7 NDAJE ME KËSTE	20
10. TRANSFERTAT	20
10.1 MES LLOGARËVE TË MIA	21
10.2 BREDA BKT SHQIPËRI	21
10.3 BREDA VENDËT, TRANSFERTA KOMBËTARE.....	22
10.4 TRANSFERTA NËKOMBËTARE, JASHTË VENDËT	22
11. PAGESAT	24
11.1 DOGANA	24
11.2 RËMBUSHJE TELEFONË	24
11.3 GJOBAT E TRAFËKUT	24
11.4 EDUKIMË	25
12. FATURAT	26

12.1	AUTORIZIMET	26
12.2	PAGESË FATURASH	27
12.2.1	<i>Faturat e autorizuara</i>	28
12.2.2	<i>Pagesë fature me Barkod</i>	28
12.2.3	<i>Faturat e fundit të paguara</i>	28
13.	PAGESA E SIGURIMEVE.....	29
13.1	MOTORIKE.....	29
13.1.1	<i>Sigurimi i detyrueshëm i mjetit (TPL)</i>	29
13.1.2	<i>Minikasko</i>	30
13.2	PRONA	30
13.3	SHËNDETI	31
13.3.1	<i>Sigurimi i Shëndetit</i>	31
13.3.2	<i>Sigurimi nga Aksidentet Personale</i>	32
13.3.3	<i>SHËNDETI NË UDHËTIM</i>	32
14.	TREGU VENDAS	33
15.	SHËRBIM KLIENTI	34
15.1	INFORMACION I PËRGJITHSHËM.....	34
15.2	NJOFTIMET NË BKT SMART	35
15.3	IDENTIFIKIMI	35
15.4	NDRYSHIMI I FJALËKALIMIT	35
15.5	KËRKESAT E MIA	35
15.6	SMART FNP	36
16.	KREDITË	36
17.	SMART INVEST.....	36
17.1	TREGU IM.....	37
17.2	FËLLO TANI	37
17.3	INVESTO FONDE	37
17.4	TËRHËQ FONDE.....	38
17.5	MBYLL SHËRBIMËN.....	38
18.	TËRHEQJE PA KARTË.....	38
18.1	KRËJO VEPRËM PA KARTË	38
18.2	TËRHEQJET E MIA	39
19.	DALJE	39
20.	PROÇESI I MBYLLJES SË BKT SMART	40
21.	PROÇESI I RIAKTIVIZIMIT TË PËRDORIMIT TË BKT SMART	40

KUSHTET E DOMOSDOSHME PËR PËRDORIMIN E BKT SMART


Shërbimi i BKT Smart mund të përdoret nëse:

1. Dini numrin e klientit (një numër 9 shifror që jepet nga punonjësi i BKT në momentin që hapet një numër llogarie në BKT) ose numrin personal të kartës suaj të identitetit (numri që fillon dhe përfundon me shkronjë)
2. Keni firmosur KSHBI (Kontrata e Shërbimeve Bankare Individuale, e cila firmoset në degë).
3. Keni një kartë aktive Debiti ose Krediti të lëshuar nga BKT.
4. Keni një numër celular të vlefshëm të regjistruar në bankë.
5. Telefoni është i lidhur me një linjë interneti gjatë kryerjes së të gjitha veprimeve.
6. Telefoni është i zgjuar.

1. INSTALIMI I BKT SMART

Për të instaluar në një telefon celular BKT Smart duhet të ndiqen hapat e mëposhtme:

1. Sigurohuni të keni numrin e klientit ose numrin personal të kartës suaj të identitetit (dhe fjalëkalimin nëse jeni regjistruar më parë në kanalën e Degës Internet)
2. Sigurohuni që numri i celularit të jetë numri që është regjistruar në BKT
3. Duhet lidhja me një linjë interneti të telefonit celular ose Wi-Fi dhe sigurohuni të keni hapësirë të mjaftueshme në memorien e celularit.
4. Aplikacioni mund të shkarkohet nga Play Store (Android) ose App Store (iOS), duke kërkuar "BKT Smart" –kërkoni logon, si më poshtë:
5. Lexoni me kujdes Kushtet e aplikacionit dhe nëse jeni dakord klikoni butonin "Allow", për vendodhjen, si më poshtë:
6. Dhe nëse doni të merrni njoftime nga BKT Smart klikoni butonin "Allow", për njoftimet, si më poshtë:




7. Automatikisht në telefonin celular do të krijohet ikona e aplikacionit dhe duke klikuar mbi të mund të hysh më pas në aplikacion.

2. INFORMACION PA HYRË NË BKT SMART

Duke **klikuar** mbi ikonën përkatëse në ekranin e hyrjes mund të kryeni veprimet e mëposhtme pa qenë e nevojshme të hyni në BKT Smart:

- Fushatat/ Paketat/ Çmimet aktuale të BKT
- Llogaritje
 - o Konvertuesi i monedhës, Llogaritësi i Depozitës/ Kredisë
 - o Klikoni mbi një nga këto opsione për të marrë informacion mbi produktin e kërkuar
- Rezervimin e Rradhës – kjo menu ofrohet vetëm për sistemin operativ Android (për këtë menu kërkohet aktivizimi i Vendodhjes/ Location)
 - o nëse klikoni mbi buton do të shfaqet lista e degëve të BKT,
 - o zgjidhni degën që do të kryeni veprime
 - o do të shfaqet lista e shërbimeve në degë
 - o Klikoni mbi shërbimin e kërkuar
 - Arkë (për veprime me para cash)
 - Shërbim me klientin (për veprime me llogaritë)
 - Kredi (për informacion mbi produktet e kredisë)
 - o Do të gjenerohet bileta e rradhës me informacionet përkatëse të cilën mund ta ruani, ndani me dikë ose ta dërgoni me email.

Këtu do të gjeni një guidë të shkurtër mbi BKT Smart




Këtu mund të ndryshoni gjuhën e aplikacionit

Këtu mund të njoftoheni me paketat ose fushatat e ndryshme të BKT

Këtu do të gjeni njoftimet e fundit të dërguara në BKT Smart

Këtu do të drejtoheni në linkun e kushteve të BKT




Këtu do të rezervoni rradhën në degën që dëshironi sipas listës

- Dega/ ATM më e afërt e BKT (për këtë menu kërkohet aktivizimi i Vendodhjes/ Location)
- Na kontaktoni
 - o Shërbimi i klientit (Contact Center)
 - o Shërbimi Whatsapp (+355674000018, ku vetëm mund të shkruani)
 - o Faqet zyrtare të BKT në rrjetet sociale
- Kursi i Këmbimit
 - o Për Monedhën Lek (ALL – Albanian Lek)
 - o Si dhe për monedhat e tjera

Këtu mund t'i shihni në hartë degët e BKT



Këtu do të shihni listën e degëve, ATM të BKT






Kursi në ALL Të tjera

Monedha I	Monedha II	Banka Bën	Banka Shet
AUD	ALL	77.8	79.0
CAD	ALL	82.9	84.15
CHF	ALL	111.15	112.85
EUR	ALL	122.5	123.1
GBP	ALL	141.7	143.85
TRY	ALL	11.623	12.53
USD	ALL	100.15	100.85

- SmartPay (Transaksione me kodin QR)*
 Është një mënyrë më e thjeshtë për të marrë dhe dërguar para, vetëm duke skanuar kodin QR. Përdoret vetëm për transfertat parash, midis klientëve të BKT-së.
 - o Fillimisht ju duhet të logoheni në SmartPay duke përdorur kredencialet tuaja.
 - o Për të krijuar një llogari QR mjafton të klikoni butonin “Krijoni Llogari QR” dhe të zgjidhni llogarinë për të cilën dëshironi të përdorni kodin QR.
 - o Për të marrë informacione mbi llogaritë e krijuara mjafton të klikoni llogarinë. Pasi të keni hapur informacionin e detajuar për llogarinë ju mund të shtoni/ modifikoni përshkrimin për këtë llogari ose ta fshini këtë llogari duke klikuar butonin “Fshij llogarinë”
 - o Kërkesa për para mund të dërgohet për një shumë specifike, duke klikuar butonin “Specifikoni shumën”, të vendosni shumën që kërkonti të merrni dhe ta dërgoni këtë kod QR, ose thjesht të dërgoni kodin QR, pa specifikuar shumën duke klikuar mbi ikonën përkatëse 🔄.
 - o Për të dërguar para ju duhet të klikoni butonin “Dërgo Para” dhe të zgjidhni llogarinë ku do t'i dërgoni këto fonde, duke përdorur një nga mënyrat e mëposhtme:
 - Skanoni kodin QR nga galeria

- Zgjidhni ikonën përkatëse  dhe skanoni kodin QR duke përdorur kamerën.




- [Lista e fushatave aktuale të BKT](#)
- [Lista e njoftimeve në BKT Smart](#)
- [Kushtet e Punës me të cilat operon BKT](#)




3. REGJISTRIMI NË BKT SMART

Pasi të keni instaluar aplikacionin e BKT Smart, klikoni mbi logon e tij dhe ndiqni hapat e mëposhtëm:

1. Hapi i parë – referojuni figurës
2. Hapi i dytë – referojuni figurës
3. Hapi i tretë – referojuni figurës
4. Hapi i katërt – referojuni figurës



5. Në faqen pasardhëse plotësoni të dhënat e kartës të lëshuar nga BKT:

- Zgjidhni tipin e kartës (nëse karta juaj ka këtë logo , tipi i kartës është "contactless");
- Vendosni 4 numrat e fundit të kartës që keni zgjedhur;
- Vendosni PIN-in e kartës që keni zgjedhur dhe më pas klikoni VAZHDO.

Pasi të kaloni me sukses hapat e mësipërme, në numrin e telefonit të regjistruar në sistemin e BKT (i cili shfaqet i koduar) do t'ju dërgohet një SMS me kodin që do të vendoset në faqen e FNP (Fjalëkalim me një Përdorim). FNP do t'ju dërgohet sa herë që të hyni në BKT Smart dhe ka një afat prej 2 minuta.

6. Vendosni kodin FNP dhe klikoni VAZHDO.

7. Krijoni një fjalëkalim sipas kriterëve të mëposhtme:

- Fjalëkalimi duhet të përmbajë karaktere alfanumerike (shkronja dhe numra);
- Fjalëkalimi duhet të jetë nga 6 deri në 16 karaktere;
- Fjalëkalimi nuk duhet të jetë i njëjtë me datëlindjen tuaj (DD/MM/VVVV);
- Fjalëkalimi nuk duhet të përmbajë numra të njëjtë ose të vazhdueshëm (psh. 111111, 123456).

4. HYRJA NË BKT SMART

Pasi të keni kryer procesin e regjistrimit, mund të hyni në BKT Smart nëpërmjet Numrit të Klientit ose Numrit Personal të kartës së identitetit ose me të dhënat e kartës së debitit ose kreditit.

4.1 Hyrja me Numër Klienti ose Numër Personal


Për të hyrë në BKT Smart duhet:

- Numri i klientit (një numër 9 shifror që jepet nga punonjësi i BKT në momentin që hapet një numër llogarie në BKT) ose numri personal i kartës suaj të identitetit (numri që fillon dhe përfundon me shkronjë);
- Fjalëkalimi (i krijuar gjatë hapave të regjistrimit ose i krijuar më parë në Degën Internet);

Nëse jeni regjistruar më parë në Degën Internet ju mund të hyni në BKT Smart me të njëjtin fjalëkalim.

Më pas klikoni butonin **"Hyrje"** për të kaluar në hapat e tjera verifikuese:

- Konfirmoni Pullën dixhitale;
- Vendosni FNP (fjalëkalim me një përdorim) të dërguar në numrin e celularit;



4.2 Hyrja me të dhënat e kartës së debitit ose kreditit

Në BKT Smart mund të hyni edhe nëpërmjet të dhënave të Kartës së Debitit ose Kreditit të lëshuar nga BKT, por pasi të keni hyrë një herë në këtë kanal me numër klienti ose numrin personal të kartës së identitetit.


Për të hyrë në BKT Smart nëpërmjet të dhënave të Kartës së Debitit ose Kreditit duhet:

- Numri i kartës së debitit/ kreditit (përdorimi i kartës sipas dëshirës)

- b. Skanimi i kartës
- c. PIN-i i kartës së debitit/ kreditit (të kartës së zgjedhur)
- d. Ditëlindja juaj

Më pas klikoni butonin “Hyrje” për të kaluar në hapat e tjera verifikuese:

- e. Konfirmoni Pullën dixhitale
- f. Vendosni FNP (fjalëkalim me një përdorim) të dërguar në numrin e celularit



4.3 Hyrja me të dhënat Biometrike*

Mënyrë tjetër për të hyrë në BKT Smart, është nëpërmjet të dhënave biometrike¹ të cilat janë regjistruar më parë në pajisjen tuaj. Të dhënat biometrike nënkuptojnë gjurmët e gishtave ose skanimin e fytyrës për aparatet celulare që i ofrojnë këto tipe identifikimi. Nëse aparati celular e ofron si hap sigurie shenjën e gishtave/ fytyrës suaj, atëherë ju mund t'i aktivizoni edhe për të hyrë në BKT Smart.

Aktivizimi i të dhënave biometrike bëhet vetëm pasi të keni hyrë një herë në BKT Smart me numër klienti ose numrin personal të kartës së identitetit dhe të keni aktivizuar këtë shërbim nëpërmjet hapave të mëposhtëm:

- a. Hyni nëpërmjet Numrit të Klientit/ Numrit Personal dhe Fjalëkalimit tuaj
- b. Konfirmoni Pullën dixhitale
- c. Vendosni FNP (fjalëkalim me një përdorim) të dërguar në numrin e celularit
- d. Zgjidhni menunë Shërbim Klienti më pas Identifikim
- e. Klikoni butonin e aktivizimit përbri butonit “Identifikim me të dhënat biometrike...”
- f. Skanoni gjurmët e gishtave/ fytyrën tuaj
- g. dhe do të merrni mesazhin e konfirmimit mbi aktivizimin e këtij opsioni

Pasi të keni kaluar hapin e aktivizimit nga menu Shërbim klienti/ Identifikim, në faqen e parë klikoni menjëherë butonin “Hyr” dhe:




- a. Klikoni mbi butonin “Hyr me të dhëna biometrike”
- b. Skanoni shenjat e gishtave/ fytyrën tuaj,

¹Aktivizimin e të dhënave biometrike e gjeni në Menunë Shërbim Klienti/ Identifikim

- c. Konfirmoni Pullën dixhitale
- d. Vendorsni FNP (fjalëkalim me një përdorim) të dërguar në numrin e celularit,

Nëse ju keni regjistruar edhe pajisjen tuaj për opsionin Smart FNP², përveç të dhënave biometrike, duke klikuar butonin “Hyr” ju mund të hyni direkt në aplikacion duke skanuar vetëm shenjat e gishtave/ fytyrën tuaj. Pra:

- a. Klikoni butonin “Hyr”
- b. a. Klikoni mbi butonin “Hyr me të dhëna biometrike”
- c. Skanoni shenjat e gishtave/ fytyrën tuaj
- d. Automatikisht do të validohet FNP dhe do të hyni direkt në aplikacion



²Aktivizimin e Smart FNP e gjeni në Meninë Shërbim Klienti/ Identifikim

5. MENU



Pasi të keni kaluar hapat me sukses, shfaqet faqja kryesore e BKT Smart, nga ku mund të shihni edhe Menunë Kryesore të produkteve dhe shërbimeve që ofrohen nga BKT Smart:

- Në grafikun e parë do të gjeni info mbi balancat tuaja në BKT e shprehur në monedhën Lek, **rrëshkisni** ekranin për të parë detyrimet mbi produktet e kredisë
- Në grafikun e dytë do të gjeni info mbi limitet që keni në BKT sipas monedhës, **rrëshkisni** ekranin për të parë limitin e kartës së kreditit

Klikoni këtu për të parë **Menunë Kryesore**

Klikoni këtu për të parë një nga paketat/ fushatat e BKT

Klikoni këtu për të parë listën e fushatave/ paketave




Klikoni/ tërhiqni këtu për të parë detajet e fushatës



6. LLOGARITË

Nëse klikoni tek Menuja Kryesore, **Llogaritë** do të drejtoheni direkt tek 2 nënmenu:




Klikoni këtu për të parë detajet e llogarive tuaja

1. Llogaritë rrjedhëse
2. Kursimet

6.1 Llogaritë Rrjedhëse


Tek kjo nënmenu do të drejtoheni tek listat e llogarive të hapura në BKT:

- Llogaritë në monedhën Lek
- Llogaritë në monedhë të huaj


Nëse klikoni mbi llogarinë që doni ose mbi shigjetën () në anë të llogarive do të shfaqet informacioni si mëposhtë:

- Monedha në të cilën është hapur llogaria,
- Emri i llogarimbajtësit
- Numri i llogarisë
- Balanca e llogarisë (në total, bashkë me shumat që mund të jenë të bllokuara për arsye të ndryshme)
- Balanca e vlefshme (gjendje të cilën mund ta përdorni)
- Shuma të bllokuara për arsye të ndryshme (nëse keni)
- Limiti i overdraftit të aprovuar (nëse keni)
- Data e hapjes së llogarisë
- Kodin IBAN të llogarisë së zgjedhur
- Dega në të cilën është hapur llogaria
- Monedha e llogarisë

Nëse klikoni butonin “Veprimet e llogarisë” do të shfaqet lista e veprimeve të fundit të llogarisë së zgjedhur.

Nëse klikoni ikonën e zarfit () tek llogaria e zgjedhur do t’ju shfaqen detajet e kërimit për të dërguar pasqyrën e llogarisë në adresën postare të regjistruar në sistemin e BKT:

- o Vendosni datat e kërimit
- o Klikoni mbi “Aprovo” (nëse doni të vazhdoni)
- o dhe në adresën e postës elektronike do të dërgohet pasqyra e detajuar e llogarisë për periudhën e zgjedhur
- o Më pas mund të zgjidhni nëse:
 - doni të bëni një kërkim të ri
 - apo të ktheheni në Faqen kryesore

Nëse klikoni në ikonën () do t’ju shfaqet informacioni për të plotësuar për një kërkim të ri të veprimeve të llogarisë së zgjedhur ku ju duhet të:

- o Vendosni datat e kërimit
- o Zgjidhni tipin e veprimit
 - Të gjitha (kreditime + debitime)
 - Kredi (shumat hyrëse në llogari)
 - Debi (shumat dalëse nga llogaria)
- o Vendosni shumën minimale dhe maksimale
- o Klikoni mbi “Aprovo” (nëse doni të vazhdoni)
- o Do të shfaqen detajet e kërimit dhe lista e veprimeve,
- o Duke rrëshqitur lart/ poshtë mund të shihni listën e veprimeve

6.1.1 Hapje Llogarie

Për të hapur një llogari të re mjafton të klikoni në ikonën e plusit () , ju mund të hapni një llogari të re rrjedhëse në monedhat:

- o Lek
- o Dollar Amerikan
- o Paund Britanik
- o Dollar Australian

- o Euro
- o Dollar Kanadez
- o Franga Zviceriane


Dhe ju jepet mundësia për të dërguar automatikisht në adresën e postës elektronike një pasqyrë të llogarisë së re në periudhën e zgjedhur.

Nëse nuk ju shfaqet adresa e postës elektronike mund ta vendosni atë në [Menunë Shërbim Klienti](#)

Llogaria rrjedhëse është aktive që në momentin e hapjes.


6.2 Kursime

Tek kjo nënmenu do të drejtoheni tek lista e llogarive të kursimeve të hapura në BKT duke **rrëshqitur poshtë/lart** mund të zgjidhni njërin nga to.


Nëse klikoni mbi llogarinë e zgjedhur ose shigjetën () do të shfaqet informacioni si mëposhtë:

- Monedha e llogarisë
- Emërtimi i llogarisë
- Numrin e llogarisë
- Balanca e llogarisë (në total, bashkë me shumat që mund të jenë të bllokuara për arsye të ndryshme)
- Balanca e Vlefshme (gjendje të cilën mund ta përdorni)
- Mbajtësi i llogarisë
- Shuma të bllokuara për arsye të ndryshme (nëse ka)
- Data e hapjes së llogarisë
- Kodin IBAN të llogarisë së zgjedhur

Nëse klikoni butonin “Lista e Veprimeve” do t’ju shfaqet lista e veprimeve të fundit të llogarisë së kursimit.


Nëse **klikoni** ikonën e zarfit () tek llogaria e zgjedhur do t’ju shfaqen detajet e kërkimit për të dërguar pasqyrën e kësaj llogarie në adresën postare të regjistruar në sistemin e BKT:


- Vendosni datat e kërkimit
- **Klikoni** mbi “Aprovo” (nëse doni të vazhdoni)
- dhe në adresën e postës elektronike do të dërgohet pasqyra e detajuar e llogarisë për periudhën e zgjedhur

Nëse **klikoni** në ikonën () do t’ju shfaqet informacioni për të plotësuar për një kërkim të ri të veprimeve të llogarisë së zgjedhur ku ju duhet të:

- o Vendosni datat e kërkimit
- o Zgjidhni tipin e veprimit:
 - Të gjitha (kreditime + debitime)
 - Kredi (shumat hyrëse në llogari)
 - Debi (shumat dalëse nga llogaria)
- o Vendosni shumën minimale dhe maksimale
- o **Klikoni** mbi “Aprovo” (nëse doni të vazhdoni)
- o Do të shfaqen detajet e kërkimit dhe lista e veprimeve,
- o Duke **rrëshqitur lart/ poshtë** mund të shihni listën e veprimeve

6.2.1 Hap Llogari Kursimi

Për të hapur një llogari të re mjafton të klikoni në ikonën e plusit (), ju mund të hapni një llogari të re kursimi në monedhat:

- o Lek
- o Euro
- o USD (Dollar amerikan)
- o GBP (Paundi Britanik)
- Vendosni emrin e llogarisë
- Zgjidhni duke klikuar/ rrëshqitur majtas/ djathas nëse doni të dërgohet automatikisht në adresën e postës elektronike një pasqyrë e llogarisë së re në periudhën e zgjedhur.
- Klikoni "Aprovo" për të vazhduar kërkesën
- Klikoni mbi llogarinë ose shigjetën () që t'ju shfaqet lista e llogarive dhe duke rrëshqitur poshtë/ lart zgjidhni llogarinë nga do të merret shuma që do të kalohet në llogarinë e kursimit të re, (balanca minimale e llogarisë së kursimit duhet të jetë 1500 Lek, 15 Eur/ USD/ GBP)
- Vendosni shumën (automatikisht do të shfaqet norma e interesit e kësaj llogarie)
- Zgjidhni duke klikuar/ rrëshqitur majtas/ djathas nëse doni të përdorni limitin e overdraft-it
- Klikoni "Vazhdo" dhe në faqen konfirmuese klikoni OK/ Anullo për të përfunduar ose anuluar kërkesën

Llogaria e kursimit është aktive që në momentin e hapjes.


7. DEPOZITAT

Në këtë menu mund të shihni informacion mbi Depozitat aktive dhe të likujduara, mund të hapësh një depozitë të re, ose të mbyllësh një depozitë aktive.

7.1 Depozitat e Mia

Tek kjo nënmenu do të shihni:


- Listën e kontratave të depozitave aktive
- dhe atyre të likujduara



Duke klikuar mbi njëren nga kontratat e depozitave ose mbi shigjetën () do të shfaqet informacioni si mëposhtë:

- Numri i kontratës së depozitës
- Shuma e Depozitës
- Vlera e interesit
- Norma e Interesit
- Periudha e maturimit
- Nëse është zgjedhur me rinovim automatik ose jo
- Nëse po, tipin e rinovimit automatik
- Data e maturitetit të kontratës së depozitës
- Dega e klientit
- Norma e Interesit
- Tipi i Depozitës
- Vlera e interesit
- Numri i kontratës së depozitës
- Dega ku është hapur depozita

- Data e fillimit të kontratës së Depozitës

7.2 Hap Depozitë

Duke **klikuar** në ikonën e plusit () ju mund të hapni një depozitë të re dhe të ndiqni hapat e mëposhtëm:


- Duke **rrëshqitur lart/ poshtë** zgjidhni mënyrën e hapjes së depozitës:
 - o Nëpërmjet listës së produkteve të BKT (me periudha fikse)
 - o Nëpërmjet Datës së maturitetit që ju dëshironi (*minimumi i periudhës së hapjes është 40 ditë*)
- Nëse keni zgjedhur të hapni depozitë **sipas produkteve të BKT**
 - o Duke **rrëshqitur majtas/ djathas** zgjidhni tipin e depozitës nga lista
 - o Duke **klikuar** mbi llogarinë ose shigjetën () zgjidhni nga lista llogarinë nga e cila do të merret shuma që do të investohet në depozitë
 - o Vendosni shumën (*minimumi 50,000.00 ALL ose 500 monedhë e huaj*)
 - o Zgjidhni nëse doni ose jo të përdorni limitin e overdraft-it (nëse keni)
 - o Interesi do të shfaqet automatikisht
 - o Zgjidhni nëse doni që kjo depozitë të riinvestohet automatikisht dhe më pas tipin e rinovimit
 - o **Klikoni** "Vazhdo" dhe më pas në faqen konfirmuese **klikoni** OK/ Anullo për të përfunduar ose anuluar kërkesën
- Nëse keni zgjedhur të hapni depozitë **nëpërmjet datës së maturimit që dëshiron** ndiqni hapat e mëposhtme:
 - o Duke **klikuar** mbi llogarinë ose shigjetën () zgjidhni nga lista llogarinë nga e cila do të merret shuma që do të investohet në depozitë
 - o Zgjidhni nga kalendari datën e maturimit të dëshiruar
 - o Vendosni shumën (*minimumi 50,000.00 ALL ose 500 monedhë e huaj*)
 - o Zgjidhni nëse doni ose jo të përdorni limitin e overdraft-it (nëse keni)
 - o Interesi do të shfaqet automatikisht
 - o **Klikoni** "Vazhdo" dhe më pas në faqen konfirmuese **klikoni** OK/ Anullo për të përfunduar ose anuluar kërkesën.

Listën e normave të interesit dhe periudhave të hapjes së depozitave mund ta gjeni në linkun: <https://www.bkt.com.al/investo/buletini-i-normave-te-interesit>

Kontrata e depozitës aktivizohet në moment.

7.3 Mbyll Depozitë

Për të mbyllur një depozitë aktive, fillimisht nga lista e Depozitave aktive, zgjidhni depozitën që doni të mbyllni:

- **Klikoni** Menu në Listat e depozitave aktive,
- Duke **klikuar** mbi depozitën ose shigjetën () zgjidhni nga lista depozitën që doni të mbyllni
- Konfirmoni duke **klikuar/ rrëshqitur djathas** opsionin për të kofirmuar mbylljen e depozitës në fund të faqes
- **Klikoni** butonin "Mbyll" për të përfunduar kërkesën

Kujdes: Nëse Depozita juaj është depozitë e tipit rekord ose është e lidhur me ndonjë produkt të bankës si garanci ajo nuk mund të mbyllet nëpërmjet BKT Smart.

Shuma e Depozitës do të kalojë në llogarinë rrjedhëse ose llogarinë e kursimeve me të cilën është lidhur depozita.


8. KARTA E DEBITIT

Këtu ju mund të lidhni ose të ndani kartën e debitit me deri në 3 llogari rrjedhëse të hapura në BKT, pavarësisht monedhës së llogarisë. Kjo mundëson shfaqjen ose jo të llogarive të lidhura me kartën e debitit në ATM e BKT.

Për të përdorur gjendjen e llogarive të lidhura me kartën e debitit mjafton zgjedhja e llogarisë gjatë vendosjes së kartës së debitit në një ATM të BKT.


8.1 Lidh llogari

Lidhja e llogarive me kartën e debitit kryhet duke:


- Zgjedhur kartën e debitit (*llogaria kryesore është gjithmonë e zgjedhur*)
- Duke **klikuar** mbi llogarinë ose shigjetën () zgjidhni duke **rrëshkitur poshtë/ lart** nga lista e llogarive të palidhura, llogarinë që doni të lidhni me kartën e debitit,
- klikoni VAZHDO dhe në faqen konfirmuese klikoni "Aprovo"


8.2 Ndaj llogari

Ndarja e llogarive me kartën e debitit kryhet duke:

- Zgjedhur kartën e debitit (*llogaria kryesore është gjithmonë e zgjedhur*)
- Duke **klikuar** mbi llogarinë ose shigjetën () zgjidhni duke **rrëshkitur poshtë/ lart** nga lista e llogarive të lidhura, llogarinë që doni të lidhni me kartën e debitit,
- klikoni VAZHDO dhe në faqen konfirmuese klikoni "Aprovo"

9. KARTAT E KREDITIT

Nëse klikoni tek Menu **Kartat e Kreditit** do të drejtoheni tek lista e kartave të kreditit. **Klikoni** mbi kartën e kreditit ose shigjetën () për të parë infon e kartës dhe nënmenutë si mëposhtë :



Mund të shihni informacionin mbi nënmenutë:

1. Pasqyrat
2. Transaksionet e fundit
3. Pagesë Karte
4. Tërheqje
5. Limiti në Internet
6. Ndaje me Këste

9.1 Info e kartës

Sapo klikon tek Menu Kartat e kreditit do të merrni informacionin mbi detajet e kartave të kreditit të lëshuara nga BKT duke ndjekur hapat e mëposhtme:

- **Klikoni** mbi kartën e kreditit ose shigjetën (>), zgjidhni kartën për të cilën kërkonti informacion dhe do të shfaqet informacioni i mëposhtëm:
 - o Tipi i kartës së kreditit (Master/ Visa card)
 - o Numri i kartës (për arsye sigurie shfaqet i koduar)
 - o Limiti i mbetur i kartës së kreditit (limiti i disponueshëm që mund të përdorni)
 - o Mbajtësi i kartës (emër mbiemër)
 - o Data e prerjes së pasqyrës së fundit të kartës së kreditit
 - o Data e fundit të pagesës për pasqyrën e fundit të kartës së kreditit
 - o Lloji i kartës (Kryesore/ Dytësore)
 - o Limiti i kartës (limiti i aprovuar nga dega)
 - o Statusi i kartës (statusi i kartës së kreditit)
 - o Shuma Bonus (shuma e përfituar nga pikët e fituara në Lekë)
 - o Pikët e fituara (pikët e fituara gjatë përdorimit të kartës së kreditit në tregtare që ofrojnë këtë shërbim)

9.2 Pasqyrat

- Klikoni mbi Pasqyrat dhe duke **rrëshqitur poshtë/ lart** zgjidhni kartën për të cilën kërkohet informacioni
- Klikoni mbi kartën e zgjedhur dhe do të shfaqet lista e pasqyrave,
- **Duke rrëshqitur poshtë/ lartë**, zgjidhni pasqyrën për të cilën kërkonti informacion
- Klikoni mbi pasqyrë dhe më pas do t'ju shfaqet lista e transaksioneve për pasqyrën e zgjedhur, **duke rrëshqitur poshtë/ lartë** mund të shihni transaksionet

9.3 Transaksionet e fundit

Këtu do t'ju shfaqet lista e transaksioneve të cilat do t'ju shfaqen në nxjerrjen e pasqyrës së ardhshme të kartës së kreditit me detajet e mëposhtme:

- Data e veprimit (data kur është kryer transaksioni)
- Shuma (shuma e transaksionit)
- Përshkrimi i veprimit (vendi ku është kryer transaksioni)
- Tipi- statusi i veprimit (statusi i transaksionit i **autorizuar** nëse është i përfunduar, ose **në proces** nëse transaksioni pritet të tërhiqet nga tregtari)

9.4 Pagesë Karte


Këtu mund të kryeni pagesa të detyrimit të kartës suaj të kreditit ose të një karte tjetër krediti të lëshuar nga BKT, duke ndjekur hapat e mëposhtme:

9.4.1. Paguaj kartën time

- **Klikoni** mbi kartën dhe duke **rrëshqitur poshtë/ lart**, zgjidhni kartën për të cilën do kryhet pagesa, nëse keni një kartë **klikoni mbi të** dhe më pas do t'ju shfaqet:
 - o Informacioni mbi kartën
 - o Informacioni mbi detyrimin
- **Klikoni** mbi llogarinë dhe duke **rrëshqitur poshtë/lart** zgjidhni llogarinë nga e cila do të kryhet pagesa e kartës së zgjedhur
- Zgjidhni tipin e pagesës:
 - o Nëse do të paguani shumën e mbetur (do të shfaqet automatikisht)
 - o Shumën minimale të mbetur (do të shfaqet automatikisht)

- o Ose një shumë tjetër (duhet plotësuar manualisht)
- Zgjidhni nëse doni ose jo të përdorni limitin e overdraft-it
- **Klikoni** butonin “Vazhdo” dhe në faqen konfirmuese zgjidhni nëse doni të dërgohet mandati në adresën e postës elektronike
- **Klikoni** OK/ Anullo për të përfunduar ose anuluar kërkesën

9.4.2. Pagesë e një karte tjetër

- Duke **rrëshqitur majtas/ djathas** në faqen e pagesës së kartës së kreditit kaloni direkt tek menu **Paguaj kartë tjetër**:
- Vendosni numrin e plotë të kartës për të cilën do të kryhet pagesa, ose klikoni ikonën e kartës () për të skanuar kartën nëse e keni fizikisht atë (skanimi i plotë mund të kryhet vetëm për kartat me fushë të bardhë dhe numrat e kartës janë shënuar me relief të theksuar) dhe klikoni “Vazhdo” ku do të shfaqet:
 - o Emri/ mbiemri i kartëmbajtësit (për arsye sigurie shfaqet i koduar)
 - o Numri i kartës (për arsye sigurie shfaqet i koduar)
- Duke **klikuar** mbi llogarinë, duke **rrëshqitur poshtë/ lart** zgjidhni llogarinë nga e cila do të kryhet pagesa
- Vendosni shumën
- Zgjidhni nëse doni ose jo të përdorni limitin e overdraft-it
- **Klikoni** “Vazhdo” dhe në faqen konfirmuese zgjidhni nëse doni të dërgohet mandati në adresën e postës elektronike
- **Klikoni** OK/ Anullo për të përfunduar ose anuluar kërkesën

Pagesa e kartës së kreditit e kryer nëpërmjet BKT Smart aktivizohet në moment.

9.5 Tërheqje

Këtu mund të transferoni limitin e tërheqjes³ nga karta juaj e kreditit në llogarinë rrjedhëse që do të zgjidhni.

- Duke **klikuar** mbi kartë dhe duke **rrëshqitur poshtë/ lart**, zgjidhni kartën nga e cila do të kryhet tërheqja, më pas do të shfaqet:
 - o Informacioni mbi kartën e zgjedhur
 - o Limiti i tërheqjes
 - o Limiti i mbetur i tërheqjes
- Duke klikuar mbi llogarinë dhe duke **rrëshqitur poshtë/ lart**, zgjidhni llogarinë tek e cila do të transferohet shuma
- Zgjidhni detajet e tërheqjes
 - o Limitin e mbetur për tërheqje (do të shfaqet automatikisht)
 - o Ose Shumë tjetër (duhet të plotësohet manualisht)
- Klikoni “Vazhdo” dhe në faqen konfirmuese zgjidhni nëse doni të dërgohet mandati në adresën e postës elektronike
- **Klikoni** OK/ Anullo për të përfunduar ose anuluar kërkesën.

Kalimi i tërheqjes në llogarinë e zgjedhur aktivizohet në moment.

9.6 Limiti në Internet

Këtu mund të aktivizoni ose ndryshoni përqindjen e limitit të kartës së kreditit për blerje në internet, nga 0-100% të limitit të kartës së kreditit:

³ Shuma e tërheqjes është 10% e limitit total të kartës së kreditit të aprovuar nga dega, i cili mund të përdoret për tërheqje në disa prej kanaleve alternative.

- Duke **klikuar** mbi kartë dhe duke **rrëshqitur poshtë/ lart**, zgjidhni kartën të cilës doni t'i ndryshoni limitin për blerje në internet dhe më pas do të shfaqet:
 - o Informacioni mbi kartën e zgjedhur
 - o Kartëmbajtësi (Emër/ mbiemër)
 - o Informacioni mbi datën e pasqyrës së fundit

Për të ndryshuar limitin për përdorim në internet ndiqni hapat e mëposhtëm:

- Vendosni vlerën e re të limitit (nga 0-100%)
- **Klikoni** "Vazhdo" dhe në faqen konfirmuese verifikoni edhe një herë të dhënat e veprimit dhe **klikoni** OK/ Anullo për të kryer ose anuluar kërkesën
- Zgjidhnini nga lista Numrin e Kartës
- Vendosni Kodin PIN të kartës së zgjedhur
- **Klikoni** "Vazhdo" për të përfunduar kërkesën

Limiti i ndryshur nëpërmjet BKT Smart aktivizohet në moment.

9.7 Ndaje me Këste

- Në menunë Kartat e kreditit zgjidhni kartën e kreditit dhe **klikoni** menunë **Ndaje me Këste**, ku do t'ju shfaqet lista e ofertave për të ndarë në këste transaksionet e kryera në POS jo të BKT:
 - o Zgjidhni ofertën sipas listës **duke rrëshqitur poshtë/ lartë**
 - o **Klikoni** Vazhdo, ku do t'ju shfaqen detajet e kësteve
 - o **Klikoni** Vazhdo dhe në faqen konfirmuese zgjidhni nëse doni të dërgohen detajet e veprimit në adresën elektronike
 - o **Klikoni** OK/ Anullo për të përfunduar ose anuluar ndarjen me këste

10. TRANSFERTAT

Nëse klikoni tek Menu **Transferrat** do të shfaqen 4 nënmenu:

The screenshot shows the BKT Smart app interface. The main menu includes: Menu Kryesore, Llogaritë, Depozitat, Kartat e Debitit, Kartat e Kreditit, Transferrat, Mes Llogarive të Mia, Brenda BKT, Brenda Vendit, Ndërkombëtare, and Pagesat. The 'Transferrat' sub-menu is expanded, showing: Mes Llogarive të Mia, Brenda BKT, Brenda Vendit, and Ndërkombëtare. Callouts provide instructions for each option:

- Klikoni këtu për të parë nënmenutë** (points to the 'Transferrat' icon)
- Klikoni këtu për të kryer një transfertë mes llogarive tuaja (në të njëjtën monedhë)** (points to 'Mes Llogarive të Mia')
- Klikoni këtu për të kryer një transfertë drejt bankave të tjera brenda vendit (në të njëjtën monedhë)** (points to 'Brenda Vendit')
- Klikoni këtu për të kryer një transfertë drejt llogarive të hapura në BKT (në të njëjtën monedhë) dhe të shihni mënyrat e kryerjes së transfertave** (points to 'Brenda BKT')
- Klikoni këtu për të kryer një transfertë drejt llogarive të hapura në banka jashtë vendit në monedhat që dëshironi.** (points to 'Ndërkombëtare')

10.1 Mes llogarive të mia

Këtu mund të kryhen transfertat mes llogarive që keni në BKT, brenda së njëjtës monedhë, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

- Klikoni mbi llogarinë ose shigjetën (>) dhe duke rrëshqitur poshtë/ lart, zgjidhni llogarinë dërguese nga e cila do të kryhet transfertat
- Vendosni shumën që do të transferohet
- Shkruani përshkrimin e transfertës (opsionale, pa karaktere speciale)
- Zgjidhni nëse doni ose jo të përdorni limitin e overdraft-it
- Klikoni mbi llogarinë ose shigjetën (>) dhe duke rrëshqitur poshtë/ lart, zgjidhni llogarinë përfituese tek e cila do të kryhet transfertat
- **Klikoni** Anullo/ Vazhdo për të kryer ose anuluar kërkesën
- Në faqen konfirmuese zgjidhni nëse doni të dërgoni mandatin në adresën e postës elektronike
- **Klikoni** OK/ Anullo për të përfunduar ose anuluar kërkesën
- Më pas mund të zgjidhni nëse:
 - Do të kryeni një transfertë të re
 - Apo të ktheheni tek Faqja kryesore

Transfertat mes llogarive janë aktive që në momentin e kryerjes.

10.2 Brenda BKT Shqipëri

Këtu mund të kryeni transfertat ndërmjet llogarive të hapura në BKT për çdo klient të BKT, në të njëjtën monedhë, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

- Zgjidhni **“Me Numër Klienti”** nëse dini numrin e klientit të përfituesit
- Zgjidhni **“Me Numër Llogarie/ kodin IBAN të llogarisë”** nëse zotëroni këtë informacion
- Me **“Me Numër Telefoni”** nëse numri i telefonit të pritësit është i regjistruar në sistemin e BKT
- Klikoni mbi llogarinë ose shigjetën (>) dhe duke rrëshqitur poshtë/ lart, zgjidhni llogarinë dërguese nga e cila do të kryeni transfertën
- Vendosni shumën që do të transferohet
- Shkruani përshkrimin e transfertës (opsionale, pa karaktere speciale)
- Zgjidhni nëse doni ose jo të përdorni limitin e overdraft-it
- Klikoni dhe vendosni numrin e klientit/ Nr e llogarisë/ kodin IBAN të përfituesit ose zgjidhni nga kontaktet/ vendosni manualisht numrin e telefonit të përfituesit (sipas nënmenusë së zgjedhur)
- Klikoni mbi Regjistro transfertën dhe vendosni një emërtim nëse doni të ruani këto të dhëna për ta kryer përsëri këtë transfertë
- **Klikoni** Anullo/ Vazhdo për të kryer ose anuluar kërkesën
- Në faqen konfirmuese zgjidhni nëse doni të dërgoni mandatin në adresën e postës elektronike
- **Klikoni** OK/ Anullo për të përfunduar ose anuluar kërkesën
- Më pas mund të zgjidhni nëse:
 - Do të kryeni një transfertë të re
 - Apo të ktheheni tek Faqja kryesore


Në fillim të faqes **klikoni** Transfertë e regjistruar dhe duke rrëshqitur lart/poshtë do të shfaqet lista e transfertave të regjistruara.

Transfertat brenda BKT janë aktive që në momentin e kryerjes.

10.3 Brenda vendit, Transferta kombëtare

Këtu mund të kryeni transfertat nga llogaritë tuaja drejt një llogarie tjetër të hapur në një bankë tjetër të nivelit të dytë në Shqipëri, në të njëjtën monedhë. *Për këtë trasfertë duhet të zotëroni kodin IBAN të llogarisë pritëse.*

Për të kryer këtë transfertë, ndiqni hapat e mëposhtëm:

- Klikoni mbi llogarinë ose shigjetën () dhe duke rrëshqitur poshtë/ lart, zgjidhni llogarinë dërguese nga e cila do të kryhet transferta
- Vendosni shumën që do të transferohet
- Shkruani përshkrimin e transfertës (opsionale)
- Zgjidhni nëse doni ose jo të përdorni limitin e overdraft-it
- Zgjidhni duke rrëshqitur poshtë/ lartë pagesën e komisioneve
- Klikoni mbi Informacionin e Përfituesit për të vendosur të dhënat:
 - o Emër dhe Mbiemër të përftuesit
 - o Zgjidhni bankën përfituese nga lista
 - o Vendosni kodin IBAN të përfituesit
 - o Vendosni nr e telefonit të përfituesit (opsionale)
- Klikoni mbi Regjistroni transfertën, dhe vendosni një emërtim nëse doni të ruani këto të dhëna për ta kryer përsëri këtë transfertë
- **Klikoni** OK/ Anullo për të kryer ose anuluar kërkesën
- Në faqen konfirmuese zgjidhni nëse doni të dërgohet mandati në adresën e postës elektronike
- **Klikoni** OK/ Anullo për të përfunduar ose anuluar kërkesën
- Më pas mund të zgjidhni nëse:
 - Do të kryeni një transfertë të re
 - Apo të ktheheni tek Faqja kryesore

Në fillim të faqes **klikoni/rrëshqit lart/poshtë** për të zgjedhur Transfertë e regjistruar, ku do të shfaqet lista e transfertave të regjistruara.

Transfertat Brenda Vedit janë aktive pas 2 ditë pune.

10.4 Transferta ndërkombëtare, jashtë vendit

Këtu mund të kryeni transfertat nga llogaritë tuaja drejt një llogarie tjetër të hapur në një bankë jashtë Shqipërisë, në çdo monedhë. *Për këtë trasfertë duhet të zotëroni kodin IBAN të llogarisë pritëse si dhe kodin SWIFT të bankës pritëse.*

Në hapin e parë do t'ju shfaqet opsioni për të përzgjedhur nëse doni të përdorni të dhënat e një Transfertë të regjistruar, ku do të shfaqet lista e transfertave të regjistruara.

Për të kryer këtë transfertë, ndiqni hapat e mëposhtëm:

- Zgjidhni tipin e transfertës:
 - o IBAN (nëse keni kodin IBAN të pritësit)
 - o Kodi SWIFT (nëse keni kodin SWIFT të bankës pritëse)
 - o Me Emër Banke (nëse nuk keni asnjë nga të dhënat më lartë por Informacionin e saktë mbi adresën e bankës pritëse)
- Plotësoni shumën e transfertës
- Zgjidhni Monedhën e transfertës
- Klikoni VAZHDO

Nëse keni zgjedhur të kryeni transfertën me kodin **IBAN**:

- Vendosni kodin IBAN të llogarisë në të cilën do të kryhet transferta (klikoni mbi butonin e validimit, për ta verifikuar nëse është i saktë)

- Automatiksht do të plotësohet Shteti i Bankës Pritëse
- Zgjidhni emrin e Bankës Pritëse ose Vendosni kodin SWIFT të Bankës Pritëse (klikoni mbi butonin e validimit, për ta verifikuar nëse është i saktë dhe automatiksht do të plotësohet Emri i Bankës pritëse)
- Vendosni emrin dhe mbiemrin e personit të llogarisë përfituese
- Numrin e telefonit të personit të llogarisë përfituese

Nëse keni zgjedhur të kryeni transfertën me Kodin **SWIFT**:

- Vendosni kodin SWIFT të Bankës Pritëse (klikoni mbi butonin e validimit, për ta verifikuar nëse është i saktë)
- Automatiksht do të plotësohet Shteti i Bankës Pritëse
- Plotësoni emrin e Bankës Pritëse
- Plotësoni numrin e llogarisë pritëse
- Plotësoni emrin dhe mbiemrin e personit të llogarisë përfituese
- Numrin e telefonit të personit të llogarisë përfituese

Nëse keni zgjedhur të kryeni transfertën me **Emrin e Bankës Pritëse** (në këtë rast sigurohuni që të dhënat janë të sakta):

- Zgjidhni Shtetin e Bankës Pritëse
- Plotësoni emrin e Bankës Pritëse
- Plotësoni adresën e Bankës Pritëse
- Plotësoni qytetin e Bankës Pritëse
- Plotësoni kodin SWIFT të Bankës Pritëse
- Plotësoni numrin e llogarisë pritëse
- Plotësoni emrin dhe mbiemrin e personit të llogarisë përfituese
- Plotësoni numrin e telefonit të pritësit

Pasi të keni plotësuar të dhënat e lartpërmendura sipas zgjedhjes së tipit të transfertës klikoni VAZHDO dhe tek faqja përmbledhëse klikoni "Aprovo" ku duhet të:

- Zgjidhni llogarinë nga e cila do të kryhet transfertat. (Sigurohuni që llogaria e zgjedhur të ketë gjendje të mjaftueshme për shumën e transfertës)
- Zgjidhni nëse doni të përdorni limitin e overdraft për të vazhduar me transfertën (nëse keni një limit overdraft të aktivizuar)
- Shkruani një përshkrim për transfertën (pa karaktere speciale)
- Zgjidhni kategorinë e qëllimit të transfertës
- Zgjidhni qëllimin e transfertës
- Zgjidhni kategorinë e klientit pritës
- Zgjidhni se cili do të jetë personi që do të paguaj komisionet. Ju mund të zgjidhni një nga opsionet:
 - o T'i mbuloni vetë të gjitha detyrimet e transfertës (të bankës nisëse dhe bankës pritëse)
 - o T'i mbulojë përfituesi të gjitha detyrimet e transfertës
 - o Ose detyrimet e bankës suaj i mbuloni vetë dhe përfituesi mbulon detyrimet e bankës së tij
